KOMUNIKATË PËR MEDIA

Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK), Tetor 2023

10.11.2023
Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit (IHÇK) për muajin Tetor 2023, viti bazë 2015=100.

Çmimet e konsumit shkuan në 3,3% vjetore dhe 0,0% mujore

Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë në një mesatare prej 3,3% në muajin Tetor 2023, krahasuar me muajin Tetor 2022. Inflacioni mujor ishte 0,0% në muajin Tetor 2023.

Norma mujore dhe vjetore e inflacionit në % të matura nga IHÇK



Tetor 2023 / Tetor 2022 3,3%

Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë në një mesatare prej (3,3%) në muajin Tetor 2023 krahasuar me muajin Tetor 2022.

Kjo kryesisht është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të konsumit në këtë periudhë te grupet dhe nëngrupet e COICOP-it: perimet (15,9%), pemët (12,1%), mallrat dhe shërbimet për mirëmbajtjen e zakonshme të ekonomisë shtëpiake (11,1 %), gjërat dhe pajisjet tjera rekreative, kopshtet dhe manaret (8,4%), prodhimet ushqimore (7,5%), pijet joalkoolike (6,9%), sheqeri, reçeli, mjalta,

çokollata dhe ëmbëlsirat (6,9%), pijet alkoolike, duhani (5,6%), rekracioni dhe kultura (5,3%), mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë (5,1%), blerja e automjeteve (4,9%), buka dhe drithërat (4,7%), restorantet dhe hotelet (4,1%), veshje dhe këpucë (3,5%), mallrat dhe shërbimet e ndryshme (3,2%), energjia elektrike, gaz dhe lendet djegëse të tjera (2,6%) dhe mishi (2,1%) me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 3,8 për qind në IHÇK-it.

Ndërsa rënie e çmimeve vërehet te grupet dhe nëngrupet e COICOP-it: vajrat dhe yndyrat (-11,3%) , lëndët djegëse të ngurta, dru zjarri, pelet etj (-9,5%) dhe qumështi, djathi dhe vezët (-1,8%) me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej -0,5 për qind në IHÇK-it.

Tetor 2023 / Shtator 2023 0,0%

Përkundër mos ndryshimit në muajin Tetor 2023 të Indeksit të harmonizuar të çmimeve të konsumit krahasuar me muajin Shtator 2023 vërehen disa ndryshime të çmimeve të artikujve dhe shërbimeve te grupet dhe nëngrupet e COICOPI-it. Rënie e çmimeve vërehet te nëngrupet: karburantet dhe lubrifikantët për pajisjet e transportit personal (-1,0%) me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej -0,1 për qind në IHÇK-it.

Ndërsa ngritja e çmimeve vërehet te grupet dhe nëngrupet e COICOP-it: veshjet dhe këpucë (1,7%) dhe mallrat dhe shërbimet e ndryshme (1,2%) me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 0,1 për qind në IHÇK-it.

Ndryshimet mujore dhe vjetore të çmimeve në % për grupe dhe nëngrupe të COICOP-it, Kosovë

COICOP	Grupet dhe nëngrupet	Peshat 2023 në ‰	X - 2023 2015=100	X - 2023 IX - 2023	X - 2023 X- 2022
00	Gjithsej IHÇK	1000.0	129.5	0.0	3.3
01	Ushqimi dhe pijet joalkoolike	381.9	142.3	0.0	3.9
02	Pijet alkoolike, duhani	64.4	137.1	0.0	5.6
03	Veshje dhe këpucë	41.1	107.9	1.7	3.5
04	Strehimi , uji, energji elektrike, gazi dhe lëndë djegëse të tjera	89.4	121.4	0.4	2.6
05	Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	62.0	120.1	0.1	5.1
06	Shëndetësia	24.1	116.7	0.2	3.8
07	Transporti	182.9	126.9	-1.2	0.6
08	Mjetet e komunikimit	21.9	114.5	0.1	-0.5
09	Rekracioni dhe kultura	36.6	106.0	0.6	5.3
10	Arsimi	5.9	104.0	0.0	1.5
11	Restorantet dhe hotelet	32.1	129.3	0.0	4.1
12	Mallrat dhe shërbimet e ndryshme	57.8	118.3	1.2	3.2

Për më shumë informata, lidhur me publikimin e Indeksit të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit (IHÇK) për muajin Tetor 2023, vizitoni: https://ask.rks-gov.net/Themes/PricesAndInflation